



**MARRËVESHJE  
BASHKËPUNIMI AKADEMIK**



Mes  
**Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Shqipëri**

Dhe

**Universitetit të Vlorës " Ismail Qemali"**

Duke u njohur me rëndësinë e shkëmbimeve në fushat e mësimdhënies dhe kërkimeve, po ashtu edhe mundësitë e siguruar nga forcimi i kontakteve mes anëtarëve të fakulteteve dhe studentëve të institucioneve, **Universiteti i Shkodrës dhe Universiteti i Vlorës** nënshkruajnë marrëveshjen e mëposhtme në fushën e bashkëpunimit akademik.

**Neni 1**

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është inkurajimi i shkëmbimeve mes **Universitetit të Shkodrës dhe Universitetit të Vlorës " Ismail Qemali"** në të gjitha fushat prezente në të dy universitetet.

**Neni 2**

Bashkëpunimi mes dy institucioneve respektive duhet të nxisë aktivitetet e mëposhtme:

- Shkëmbime dhe bashkëpunime reciproke të profesorëve, kërkuesve, studentëve dhe stafit tjetër në nivelin universitar dhe pas universitar;
- Organizimi i shkollave verore, seminareve, dhe formave të tjera shkëmbimi njohurish nga palët;
- Shkëmbim literature, teksteve dhe publikimeve universitare;
- Realizimi i projekteve të përbashkëta;
- Shkëmbime eksperiencash në programe reciproke në fushën e sistemeve të informacionit dhe komunikimit;
- Shkëmbim stafi administrativ me qëllim përfitim eksperience dhe ndryshimeve të nevojshme;
- Bashkëpunimi në fushën e reformës universitare sipas Deklaratës së Bolonjës dhe Deklaratës së Lisbonës;

- Si dhe forma të tjera bashkëpunimi me qëllim që të jenë reciprokisht përfituese për të dyja palët.

### **Neni 3**

Të gjitha aktivitetet e përmendura në Nenin 2 do të bazohen mbi reciprocitet.

### **Neni 4**

Të dy Universitetet të paktën një herë në vit do bien dakort mbi format dhe fushat konkrete të bashkëpunimit. Këto programe të përbashkëta mund të ndryshohen dhe të amendësohen nga një marrëveshje e shkruar dhe e firmour nga të dyja palët.

### **Neni 5**

Aktivitetet e përbashkëta do të rishikohen çdo vit.

### **Neni 6**

Marrëveshja prezente nënshkruhet si një marrëveshje e vazhdueshme pa limite kohore.

### **Neni 7**

Marrëveshja hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit të saj nga palët.

### **Neni 8**

Secili Universitet ka të drejtë të propozojë aneksime dhe ndryshime të dokumentit në formë të shkruar dhe ndryshimet do fillojnë pas përshtatjes së tyre nga palët.

### **Neni 9**

Secili Universitet ka të drejtë të ndërpresë marrëveshjen prezente duke paraqitur një lajmërim me shkrim të paktën gjashtë muaj para afatit.

### **Neni 10**

Aktivitetet që nuk janë përfshirë në këtë Marrëveshje do akordohen nga palët, të cilat do vazhdojnë të kenë kontakte, vullnetin e mirë, fleksibilitetin dhe cilësinë e adaptueshme për realizimin e kësaj marrëveshjeje.

**Neni 11**

Kjo Marrëveshje do paraqitet në gjashte kopje identike ( dy në gjuhën shqipe, dy në gjuhën serbe dhe dy në gjuhën angleze). Secili Universitet do marrë nje kopje ( një kopje në secilën gjuhë).

**Prof. dr. Adem Bekteshi**

**Rektori**  
**Universiti i Shkodrës**



**Data** 03.12.2019

**Vendi** Shkoder

W=4238 Prot.

**Prof. Dr Roland Zisi**

**Rektori**  
**Universiteti Vlorës**

